



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**  
**Komisioni Parlamentar për Integrimin Europian**

**Dokument Parlamentar**

**RAPORT**

**PËR**

**PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES STATUSORE,  
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT EUROPIAN,  
MBI VEPRIMET E NDËRMARRA NGA AGJENCIA E ROJËS BREGDETARE  
DHE KUFIRIT EUROPIAN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Komisioni për Integrimin Europian (në vijim Komisioni), bazuar në Nenet 18, 32, 34 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në mbledhjen e zhvilluar në datë 04.02.2019, me cilësinë e **Komisionit për dhënie mendimi**, mori në shqyrtim projektligjin **“Për ratifikimin e marrëveshjes statusore, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, mbi veprimet e ndërmarra nga Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit Europian në Republikën e Shqipërisë”**.

Për paraqitjen e këtij projektligji, në mbledhje ishte e pranishme **Ministria e Brendshme**.

**1. Qëllimi i projektligjit**

Projektligji parashikon ratifikimin e marrëveshjes statusore, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, mbi veprimet e ndërmarra nga Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit Europian në Republikën e Shqipërisë.

Kjo marrëveshje synon:

- rritjen e nivelit të bashkëpunimit të vendit tonë me vendet e BE-së në kuadrin e menaxhimit të kufijve dhe emigracionit të paligjshëm si dhe gjatë zhvillimit të operacioneve të kthimit e ripranimit;
- pjesëmarrjen në operacione të përbashkëta dhe trajnime;
- rritjen e nivelit profesional të punonjësve të policisë së shtetit dhe përcaktimin e detyrave e të kompetencave për menaxhimin dhe zgjidhjen e situatave;
- rritjen e bashkëpunimit operacional, shkëmbimin e informacionit si dhe krijimin e mundësisë për përdorimin e aseteve teknike e logjistike edhe në kufijtë e vendit tonë, në rastet e mundshme të flukseve të mëdha migratore, të papërballueshme me kapacitetet njerëzore dhe teknike të vendit tonë.

Me anë të kësaj marrëveshjeje synohet forcimi i bashkëpunimit në fushën operacionale, për të luftuar emigracionin e paligjshëm, krimin ndërkufitar si dhe kryerjen e operacioneve të kthimit e të ripranimit në lidhje me menaxhimin e kufijve. Kjo marrëveshje do t'i hapë rrugë

bashkëpunimit në fushat e shkëmbimit të informacionit, analizës së riskut, trajnimit, kërkimit, zhvillimit të projekteve pilot, dhe operacioneve të përbashkëta.

Autoriteti kompetent për zbatimin e kësaj Marrëveshje në Republikën e Shqipërisë do të jetë Ministria e Brendshme ndërsa për Bashkimin European do të jetë Agjencia e Rojës së Kufirit dhe Bregdetit European në Republikën e Shqipërisë.

## **2. Plani Kombëtar për Integrimin European 2018-2020**

Ky projektligj është në përputhje me prioritetet e përcaktuara në **PKIE 2018 - 2020, Kapitulli 24 “Drejtësia, Liria dhe Siguria”**.

## **3. Acquis e BE-së në fushën e veprimit të Projektligjit**

Acquis e BE-së në fushën e veprimit të projektligjit përbëhet nga legjislacioni parësor dhe dytësor.

Legjislacioni parësor i BE-së:

- **Traktati mbi Funksonimin e Bashkimit European (TFBE):** Pjesa e Tretë “Politikat dhe Veprimet e Brendshme të Bashkimit”, Titulli V “Zona e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë”, **Kreu II “Politikat për kontrollet kufitare, azilin dhe imigrimin”, Neni 77** (ish - Neni 62 i TKE), **Neni 79** (ish-neni 63, pikat 3 dhe 4 të TKE).
- **Marrëveshja e Stabilizim Asociimit BE-Shqipëri (MSA):** Titulli VII “Liria, Drejtësia dhe Siguria”, **Neni 80** “Vizat, menaxhimi i kufijve, azili dhe migracioni”, **Neni 81** “Parandalimi dhe kontrolli i imigrimit të paligjshëm; ripranimi”.

Legjislacioni dytësor i BE-së:

- **Rregullorja (BE) 2016/1624 e Parlamentit European dhe e Këshillit, datë 14 shtator 2016 “Mbi Rojën e Kufirit dhe Bregdetit European dhe që ndryshon Rregulloren (BE) 2016/399 të Parlamentit European dhe të Këshillit dhe që shfuqizon Rregulloren (KE) Nr.863/2007 të Parlamentit European dhe të Këshillit, Rregulloren e Këshillit (KE) Nr.2007/2004 dhe Vendimin e Këshillit 2005/267/KE”.**

**Neni 77, pika 1, shkronjat “c” e TFBE-së** parashikon se Bashkimi European harton një politikë me qëllim vendosjen graduale të një sistemi të menaxhimit të integruar të kufijve të jashtëm. Kurse, **pika 2, shkronjat “b” dhe “d” të këtij neni** parashikojnë se për qëllimet e pikës 1, Parlamenti European dhe Këshilli miratojnë, sipas procedurës së zakonshme legislative masa në lidhje me kontrollet të cilave u nënshtrohen personat që kalojnë kufijtë e jashtëm si dhe çdo masë të nevojshme për vendosjen graduale të një sistemi të menaxhimit të integruar për kufijtë e jashtëm.

**Neni 79, pika 1 e TFBE-së** parashikon se Bashkimi European harton një politikë të përbashkët për imigrimin me qëllim sigurimin, në të gjitha fazat e menaxhimit efikas të flukseve migruese të trajtimit të drejtë të shtetasve të vendeve të treta që qëndrojnë ligjërisht në Shtetet Anëtare dhe të parandalimit të imigracionit të paligjshëm dhe trafikimit të qenieve njerëzore si dhe të përf forcimit të masave për t’i luftuar këto dy fenomene. Kurse, **pika 2, shkronja “c” e këtij neni** parashikon se për qëllimet e pikës 1, Parlamenti European dhe Këshilli, miratojnë sipas procedurës së zakonshme legislative, masa lidhur me imigracionin

e paligjshëm dhe qëndrimin pa leje, duke përfshirë largimin dhe riatdhesimin e personave që qëndrojnë pa leje.

**Neni 80 i MSA-së** parashikon bashkëpunimin mes Shqipërisë dhe BE-së në fushën e vizave, kontrollit të kufijve, azilit dhe migracionit si dhe në vendosjen e një kuadri bashkëpunimi mes tyre në këto fusha. Bashkëpunimi në çështjet e sipërpërmendura bazohet në konsultimet e ndërsjella dhe bashkërendimin e ngushtë ndërmjet palëve dhe përfshin, ndër të tjera, asistencën teknike dhe administrative për trajnimin e personelit si dhe menaxhimin e kufijve.

**Neni 81 i MSA-së** parashikon bashkëpunimin mes Shqipërië dhe BE-së në parandalimin dhe kontrollin e imigrimit të paligjshëm dhe ripranimin. Shqipëria dhe Shtetet Anëtare të BE-së bien dakord që, sipas kërkesës dhe pa formalitete të mëtejshme, i) të ripranojnë çdo shtetas të tyre që qëndron në mënyrë të paligjshme në territoret e tyre; ii) të ripranojnë çdo shtetas të vendeve të treta dhe çdo person pa shtetësi që qëndron në mënyrë të paligjshme në territorin e tyre dhe që ka hyrë në territorin e Shqipërisë nëpërmjet një Shteti Anëtar, ose prej tij, apo që ka hyrë në territorin e një Shteti Anëtar nëpërmjet Shqipërisë, ose prej saj.

**Rregullorja e BE-së 2016/1624** e datës 14 shtator 2016 krijon Rojën e Kufirit dhe Bregdetit European për të siguruar, për herë të parë, zbatimin efektiv të menaxhimit të integruar të kufijve në kufijtë e jashtëm të BE-së si dhe të shteteve të asociuara në hapësirën Shengen (Islanda, Norvegjia dhe Zvicra).

**Roja e Kufirit dhe Bregdetit European** përbëhet nga: i) **Agjencia e Rojës së Kufirit dhe Bregdetit European (“Agjencia”)**, e krijuar në bazë të Agjencisë ekzistuese të Kufijve të BE-së (e njohur si Frontex) dhe ii) **autoritetet kombëtare të Shteteve Anëtare të BE-së dhe të Shteteve të Asociuara në hapësirën Shengen, që janë përgjegjëse për menaxhimin e kufijve** (Neni 3 i Rregullores së BE-së 2016/1624). Misioni i Rojës së Kufirit dhe Bregdetit European është të zbatojë menaxhimin e integruar të kufijve të BE-së si një përgjegjësi e përbashkët e Agjencisë dhe e autoriteteve kombëtare që janë përgjegjëse për menaxhimin e kufijve (neni 5 i Rregullores së BE-së 2016/1624).

**Pika 4 e Nenit 54 “Bashkëpunimi me Shtetet e Treta”** i Rregullores së BE-së 2016/1624 parashikon se në rastet kur anëtarët e ekipit të Agjencisë do të kenë kompetenca ekzekutive në aksionet që do të zhvillohen në territorin e shteteve të treta, një marrëveshje statusore duhet të përfundohet mes BE-së me shtetit të tretë në fjalë. Marrëveshja statusore duhet të mbulojë të gjitha aspektet që janë të nevojshme për kryerjen e aksioneve, duke përfshirë: qëllimin e operacionit, përgjegjësitë civile dhe penale të anëtarëve të ekipit, si dhe detyrat dhe kompetencat e anëtarëve të ekipit. Marrëveshja statusore duhet të sigurojë respektimin e plotë të të drejtave themelore gjatë kryerjes së operacioneve.

#### **4. Përfundime**

**Projektligji** “Për ratifikimin e marrëveshjes statusore, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, mbi kryerjen e aksioneve nga Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit European në Republikën e Shqipërisë”, **nuk synon të përafrojë ndonjë akt të veçantë të legjislacionit të Bashkimit Evropian.**

Pavarësisht kësaj, ky projektligj është në përputhje me:

- **Nenin 77, pika 1, shkronjat “c” të TFBE-së** që parashikon se Bashkimi European harton një politikë me qëllim vendosjen graduale të një sistemi të menaxhimit të integruar të kufijve të jashtëm,
- **Nenin 79, pika 1 të TFBE-së** që parashikon se Bashkimi European harton një politikë të përbashkët për imigrimin,
- **Nenin 80 të MSA-së** që parashikon bashkëpunimin mes Shqipërisë dhe BE-së në fushën kontrollit të kufijve dhe migracionit,
- **Nenin 81 të MSA-së** që parashikon bashkëpunimin mes Shqipërisë dhe BE-së në parandalimin dhe kontrollin e imigrimit të paligjshëm dhe ripranimin,
- **Nenin 54, pika 4 të Rregullores së BE-së 2016/1624** që parashikon se në rastet kur anëtarët e ekipit të Agjencisë do të kenë kompetenca ekzekutive në aksionet që do të zhvillohen në territorin e shteteve të treta, një marrëveshje statusore duhet të përfundohet mes BE-së dhe shtetit të tretë në fjalë.

**Komisioni, pas shqyrtimit të projektligjit, e miratoi atë shumicë votash.**

**KRYETAR  
GENC POLLO**